

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6653
E enjte, 14 korrik 2022
çmimi 0.40 €

Reagim i KMDLNj-së

Pse familjarët e pengjeve të Gjykatës Speciale nuk pajisen me vizë afatgjatë?! | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E 13-TË NDAJ THAÇIT, VESELIT, KRASNIQIT DHE SELIMIT | FAQE 4-5

MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-së KËRKON NGA PROKURORIA DORËZIMIN E MATERIALEVE SHFAJËSUESE



Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë të mërkurën është mbajtur konferenca e 13-të për ecurinë e çështjes në rastin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Mbrojtja ka kërkuar që prokuroria t'ia vë në dispozicion menjëherë dokumentet të cilat lidhen me materialet shfajësuese

dhe, sipas saj, ZPS-ja ka materialet të tilla, por nuk i dorëzon ato. Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Kehoe, ka thënë se prokuroria duhet t'i dorëzojë materialet shfajësuese menjëherë dhe jo t'i kërkojë ta bëjë një gjë të tillë, duke shtuar se ky është detyrim për ZPS-në

AKTUALE



ÇITAKU: QYTETARËT NË LUFTË PËR EKZISTENCË, KURTI NË 100 DITËT E FUNDIT, 45 I KALOI JASHTË VENDIT | F. 5

SHQIPËRIA I OFRON NATO-S BAZË DETARE NË DURRËS | F. 2

NË VERI, TARGAT RKS MBULOHEN ME ATO KM | F. 3

EKONOMI



QEVERIA PARALAJMËRON MASA PËR PRODHIMET BAZË | F. 8

DOGANA KONFISKON 675 LITRA VAJ, KONTRABANDË NGA SERBIA | F. 8

SPORT



ERMAL KRASNIQI MERR PËRGJEGJËSINË E ELIMINIMIT TË BALLKANIT NGA LIGA E KAMPIONËVE | F. 10



MOBILIZOHEN INSTITUCIONET PAS SHTIMIT TË RASTEVE ME COVID | FAQE 3



PAS NDËRPRERJES SË SHËRBIMEVE NË ONKOLOGJI, SHQIPËRIA I PRANON PACIENTËT NGA KOSOVA | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mbr: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shqipëria i ofron NATO-s bazë detare në Durrës

BRUKSEL, 13 KORRIK - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i ofroi të mërkurën NATO-s portin e Durrësit për ta ndërtuar një bazë të flotës detare, ndërkohë që kërkoi dialog të vazhdueshëm të aleancës me Ballkanin Perëndimor për ta shmangur përshkallëzimin e tensioneve në rajon. "Është e rëndësishme që ne ta vazhdojmë bashkëbisedimin përkundrejt situatës dhe, po

kështu, detyrimet që i kemi në Ballkanin Perëndimor, që pikërisht të parandalojmë çdo përshkallëzim dhe të parandalojmë që çdo ndikim i keq të kthehet në problem për rajonin tonë", tha Rama në konferencën e përbashkët me sekretarin e përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Në këtë kontekst, ai tha se Shqipëria do të vazhdojë ta luajë rolin e vet tradicional "në mbështetje të paqes

rajonale, pajtimit dhe sigurisht stabilitetit", teksa kërkoi dialog të vazhdueshëm të Aleancës me Serbinë. "Ne besojmë shumë që është tejet e rëndësishme të vijojmë një dialog të përhershëm me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Serbinë e cila nuk është pjesë e Aleancës sonë, por ende është pjesë e rajonit tonë", u shpreh Rama dhe kërkoi



edhe përfshirjen e Kosovës në Partneritetin për Paqe, pa marrë parasysh kufizimet politike nga disa anëtarë që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Sri Lanka shpall gjendje të jashtëzakonshme pas arratisjes së presidentit

SRI JAYAWARDENAPURA -Kotte, 13 korrik - Sri Lanka shpalli gjendjen e jashtëzakonshme të mërkurën pasi presidenti u largua jashtë shtetit për t'u shpëtuar protestave antiqeveritare, pasi mijëra njerëz dolën në rrugë, përsëri të zemëruar që ai ende nuk ishte dorëzuar.

Presidenti i Sri Lankës, Gotabaya Rajapaksa, ka ikur në Maldive herët të mërkurën, pas protestave të gjera kundër krizës më të keqe ekonomike në vend në disa dekada.

Disa orë më vonë, pa asnjë njoftim zyrtar se ai do të tërhiqej, mijëra protestues sulmuan zyrën e kryeministrit Ranil Wickremesinghe, të cilin Rajapaksa e emëroi president në detyrë gjatë mungesës së tij. Ata kërkuan që të dy zyrtarët të largoheshin. "Shko në shtëpi



Ranil, shko në shtëpi Gota", bërtitën ata.

Protestuesit antiqeveritar të Sri Lankës kanë hyrë edhe në stacionin kryesor televiziv shtetëror të mërkurën dhe për pak kohë morën përsipër transmetimin.

Një burrë i paidentifikuar hyri

në studion e rrjetit Rupavahini gjatë një programi live dhe urdhëroi që të transmetoheshin vetëm lajme të lidhura me protestën. Transmetimi u ndërpre dhe u zëvendësua me një program të regjistruar.

Protestuesit në Sri Lankë gjatë

fundjavës kanë hyrë edhe brenda pallatit presidencial. Presidenti i Sri Lankës, Gotabaya Rajapaksa, i cili iku në Maldive të mërkurën, i telefonoi kryetares së parlamentit dhe i tha se letra e tij e dorëheqjes do të dërgohet më vonë gjatë ditës.

"Presidenti ra në kontakt me mua përmes telefonit dhe tha se ai do të sigurojë që letra e tij e dorëheqjes do të merret nga unë sot", tha kryetarja Mahinda Yapa Abeywardena në një deklaratë me video.

"I bëj thirrje publikut që të ketë besim në procesin parlamentar për të emëruar një president të ri me datën 20 dhe të [i kërkoj] të jetë paqësor".

Rajapaksa gëzon imunitet nga arrestimi dhe besohet se ai donte të largohej para se të

jepte dorëheqje në mënyrë që mos të mund ta ndalonin kur të mbetej pa pushtet.

Ai, gruaja e tij dhe dy truporjat ishin katër pasagjerët në bordin e një avioni ushtarak Antonov-32 që u ngrit nga aeroporti kryesor ndërkombëtar i Sri Lankës, thanë burimet e imigracionit për AFP-në.

Me të mbërritur në Maldive, ata u çuan në një vend të pazbuluar, nën shoqërimin e policisë, tha një zyrtar i aeroportit në kryeqytetin Male.

Protestuesit në Sri Lankë, që gjatë fundjavës hynë në pallatin presidencial dhe dogjën shtëpinë e kryeministrit, kanë kërkuar dorëheqjen e presidentit dhe kryeministrit për shkak të krizës ekonomike.

Gjermania më 1 gusht do ta ndalojë blerjen e qymyrit rus, naftën në dhjetor

BERLIN, 13 KORRIK - Gjermania do t'u japë fund blerjeve të qymyrit rus më 1 gusht dhe do ta ndalojë blerjen e naftës ruse më 31 dhjetor, pasi vendi kërkoi t'i japë fund varësisë së tij energjetike nga Rusia pas vendimit të Moskës për ta pushtuar Ukrainën. Rusia më parë ka furnizuar me 40 për qind të qymyrit Gjermaninë dhe me 40 për qind të naftës, tha zëvendësministri i Financave, Joerg Kukies, më 13 korrik, në Forumin Energjetik të Sidneit, të organizuar nga qeveria australiane dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë. "Kushdo që e njeh historinë e tubacionit të naftës Druzhba, i cili tashmë ishte një mjet i perandorisë sovjetike mbi Evropën Lindore, të çliros veten nga kjo varësi nuk është një çështje e parëndësishme, por është një gjë që do ta arrijmë brenda pak muajsh", tha Kukies.

Ai shtoi se sfida kryesore përpara do të jetë plotësimi i boshllëkut masiv që do të mbetet në furnizimet me gaz pasi Gjermania dhe i gjithë Bashkimi Evropian të heqin dorë nga furnizimet ruse të cilat tani arrijnë në 158 miliardë metra kub në vit. Gjermania po lëviz me shpejtësi në zhvillimin e terminaleve të importit të gazit natyror të lëngshëm (LNG) për të ndihmuar në zbutjen e hendekut të furnizimit me gaz.

Kukies tha se Shtetet e Bashkuara dhe Katari mund të furnizojnë së bashku rreth 30 bcm gaz në formë LNG në Evropë, por se një hendek i madh do të mbetet ende. "Ne nuk mund të urojmë që ky problem të largohet", tha ai. Ndërkohë, Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tyre të Grupit të Shtatë (G7) po punojnë për masa të reja për ta ulur aftësinë e Rusisë për ta financuar luftën e saj në Ukrainë, ndërsa në të



njëjtën kohë kërkojnë ta ulin çmimin e naftës dhe benzinës ngaqë rritja në nivele të tilla mund të godasë ekonominë globale, duke vendosur një kufi mbi çmimin e blerjeve të naftës ruse.

Sekretarja e Thesarit e ShBA-së, Janet Yellen, po viziton vendet e

Indo-Paqësorit për të lobuar për propozimin. Në Tokio, më 12 korrik, Yellen dhe ministri japonez i financave, Suzuki Shunichi, thanë se të dy vendet kanë rënë dakord ta eksplorojnë "fizibilitetin e kufizimeve të çmimeve aty ku është e përshtatshme".

Propozimi i G7-s është t'u lidhë shërbimet financiare, sigurimet dhe transportin e ngarkesave të naftës me një tavan çmimi. Një dërgues ose një importues mund të ketë qasje në këto shërbime vetëm nëse angazhohet për një çmim maksimal të caktuar për naftën ruse.

Mobilizohen institucionet pas shtimit të rasteve me Covid

Të mërkurën janë konfirmuar 763 raste të reja me Covid në Kosovë. Në 24 orët e fundit është shënuar edhe një rast i vdekjes. Raste aktive me Covid janë 2 184. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Kosova po vazhdon të shënojë shtim të rasteve të reja të Covid-19 me tendencë të rritjes ditët në vijim. Pas rritjes së rasteve të reja me Covid, drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, ka thirrur të mërkurën në takim drejtorët e spitaleve të përgjithshme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 KORRIK - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 2 030 testimeve, janë konfirmuar 763 raste të reja me Covid. Në 24 orët e fundit është shënuar edhe një rast i vdekjes. Në këtë periudhë kohore janë shënuar edhe 213 persona. Raste aktive me Covid janë 2 184.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Kosova po vazhdon të shënojë shtim të rasteve të reja të Covid-19 me tendencë të rritjes ditët në vijim. "Fatkeqësisht, sot është raportuar një rast i vdekjeve nga kjo sëmundje. Në vende të ndryshme të botës po regjistrohen raste të shumta të Covid-19, sepse pandemia

Covid-19 nuk ka mbaruar. IKShPK-ja është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje të shijes, rekomandohen të testohen", ka njoftuar IKShPK-ja.

Ky institut ka njoftuar se "me qëllim të përforcimit të imunitetit dhe parandalimit të rasteve të reja dhe formave të rënda të sëmundjes, qytetarët këshillohen që të vaksinohen, me dozën e parë të dytë dhe të tretë mund të vaksinohen të gjithë personat e moshës mbi 12 vjeç; me dozën e katërt mund të vaksinohen personat e moshës

mbi 60 vjeç, me kusht që të kenë kaluar katër muaj nga marrja e dozës së tretë".

MSh-ja dhe IKShPK-ja u bëjnë thirrje qytetarët që, pavarësisht prej situatës së qetë dhe stabile epidemiologjike në vend, të jenë të kujdesshëm për zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjithëse dhe të vaksinohen kundër Covid-19. Drejtori i ShSKUK-së, Valbon

Krasniqi, ka thirrur të mërkurën në takim drejtorët e spitaleve të përgjithshme pas rritjes së rasteve të reja me Covid. Ai ka thënë se e ka parë të arsyeshme këtë takim në mënyrë që të mobilizohen për ndonjë valë të madhe të Covid-19 në vend. "Ky është një aktivitet i zakonshëm me rastin e infeksionit me Covid. Dje kam pasur takim me komunitetin,

prandaj e pashë të arsyeshme t'ju ftoj si drejtorë të spitaleve për të kërkuar një mobilizim për ndonjë valë të madhe", ka thënë ai.

Fazli Shala, drejtor i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, ka thënë se momentalisht në spital janë të shtrirë tetë pacientë me Covid, tre prej tyre janë në gjendje të rëndë dhe dy me oksigjeno-terapi.

Në veri, targat RKS mbulohen me ato KM

PRISHTINË, 13 KORRIK - Veturat me targa RKS (Republika e Kosovës) në Mitrovicë të Veriut gjatë natës janë mbuluar me letra ngjithëse me KM (Mitrovica e Kosovës), kurse stema e Kosovës është mbuluar me atë të Serbisë.

Zëvendës drejtori i Policisë për rajonin e veriut, Besim Hoti, konfirmoi për "Radion Evropa e Lirë" se zyrtarët policorë kanë dalë në terren pas ankesës së një qytetari dhe kanë kryer hetime. Sipas tij, tani pritet vendimi i prokurorit për të përcaktuar nëse ka elemente për të iniciuar një rast. Hoti tha se bëhet fjalë për një numër më të vogël të veturave, por se nuk e di numrin e saktë pasi, me gjasë, shumica, siç tha ai, as nuk kanë raportuar rastet tek autoritetet, por vetëm i kanë hequr letrat ngjithëse të vendosura në targat e veturave të tyre.

Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që nga 1 gushti ta mundësojë reregjistrimin e veturave që përdorin targa me qytetet e Kosovës, të cilat janë të regjistruar në Serbi, dhe kanë targa të tilla si PR (Prishtinë), KM (Mitrovica e Kosovës), UR (Ferizaj) etj. Afati për reregjistrim do të zgjasë deri më 30 shtator. Veturat me targa të tilla qarkullojnë vetëm në veri të Kosovës dhe besohet se janë rreth 10 000 vetura me targa KM.

Sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës, reregjistrimi me targat RKS do të vlejë për të gjitha veturat e regjistruara në sistemin serb në periudhën prej 10 qershorit 1999 deri më 21 prill të këtij viti.

Në vendim thuhet se pas afatit të përcaktuar nuk do të mund të bëhet reregjistrimi i veturave që kanë targa të lëshuara nga Serbia.

Çështja e targave nxiti tensione midis Prishtinës dhe Beogradit shtatorin e vitit të kaluar, pasi Kosova vendosi masa reciprociteti ndaj Serbisë, gjegjësisht nisi lëshimin e targave provuese për të gjithë personat që drejtonin vetura me targa të qyteteve të Serbisë.

Më pas, Qeveria e Kosovës tha se të gjitha targat KM do të largohen nga veturat e qytetarëve në veri të Kosovës, njoftim ky që shtyri serbët lokalë të bllokoi për dy javë pikëkalimet kufitare midis Kosovës dhe Serbisë, në Jarinjë dhe Bërnjak.

Kosova dërgoi në këto dy pikëkalime njësitë speciale të policisë, ndërkaq avionët ushtarakë serbë u panë disa herë duke fluturuar afër Jarinjës. Atëbotë Beogradi zyrtar tha se njësitë e ushtrisë serbe ishin në gatishmëri të lartë në garnizonet e Rashkës dhe Novi Pazarit, dy qytete pranë kufirit



me Kosovën.

Pas ndërmjetësimit të Bashkimit Evropian, tensionet u ulën dhe palët u pajtuan për një zgjidhje të përkohshme për targat, përkatësisht për t'i mbuluar simbolet shtetërore me letra të bardha ngjithëse. Regjimi i letrave ngjithëse u zbatua edhe për targat KM. Kosova dhe Serbia duhej të arrinin një zgjidhje afatgjatë për targat në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, por

kjo nuk ndodhi për shkak të qëndrimeve të ndryshme të palëve.

Më 29 qershor përfaqësuesi i posaçëm i BE-së për dialogun midis Prishtinës dhe Beogradit, Miroslav Lajçak, tha se ka shpresë që dialogu në nivelin e lartë politikë do të vazhdojë në muajin korrik.

Në po të njëjtën ditë Qeveria e Kosovës miratoi vendimin për reregjistrimin e veturave me targa të qyteteve të Kosovës që

lëshohen nga autoritetet serbe, gjë që nxiti reagim të ashpër nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i cili tha se nuk do të ketë dialog.

Më pas, më 30 qershor, Lajçaku deklaroi se në raportet midis Kosovës dhe Serbisë është krijuar një "situatë e re" dhe nuk dihet nëse do të ketë takim gjatë korrikut ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq.



ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E 13-TË NDAJ THAÇIT, VESELIT, KRASNIQIT DHE SELIMIT

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së kërkon nga prokuroria dorëzimin e materialeve shfajësuese

Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë të mërkurën është mbajtur konferenca e 13-të për ecurinë e çështjes në rastin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Mbrojtja ka kërkuar që prokuroria t'ia vë në dispozicion menjëherë dokumentet të cilat lidhen me materialet shfajësuese dhe, sipas saj, ZPS-ja ka materiale të tilla, por nuk i dorëzon ato. Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Kehoe, ka thënë se prokuroria duhet t'i dorëzojë materialet shfajësuese menjëherë dhe jo t'i kërkojë të bëjë një gjë të tillë duke shtuar se ky është detyrim për ZPS-në

“Epoka e re”

HAGË, 13 KORRIK - Në konferencën e 13-të për ecurinë e çështjes në rastin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit, mbrojtja dhe prokuroria kanë vazhduar të mërkurën diskutimin rreth nxjerrjes së materialeve. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi këtë konferencë e kanë përcjellë përmes videolidhjes. Mbrojtja ka kërkuar që prokuroria t'ia vë në dispozicion menjëherë dokumentet të cilat lidhen me materialet shfajësuese dhe, sipas saj, ZPS-ja ka materiale të tilla, por nuk i dorëzon ato. Avokati i ish-presidentit Hashim Thaçi, Gregory Kehoe, ka thënë

se prokuroria duhet t'i dorëzojë materialet shfajësuese menjëherë dhe jo t'i kërkojë të bëjë një gjë të tillë duke shtuar se ky është detyrim për ZPS-në. “Kur ZPS-ja vendohet në pozitë të vështirë, atëherë dorëzon material shfajësues. Është shumë e thjeshtë, kjo është një çështje e cila ka hasur shumë probleme nga ana e prokurorisë, ka dokumente shfajësuese në posedim të ZPS-së aktualisht, duke lënë me një anë mocionin që kemi dorëzuar sot lidhur me dokumentet serbe të cilat ju i keni parë, i nderuar gjykatës. Pra, është një proces që duhet bërë dhe bëhet mirë të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Ata duhet ta bëjnë dorëzimin e këtyre materialeve tani”, ka thënë ai.

Për këtë ka folur edhe mbrojtja e

Jakup Krasniqit, Aydan Elis, i cili ka thënë se nxjerrja e materialeve shfajësuese nuk duhet të shtyhet më. “Ajo për të cilën ne duam që t'i dalim situatës përpara është që nxjerrja e materialeve shfajësuese është detyrim i vazhdueshëm për prokurorinë, kështu që prokuroria nuk duhet t'i bëjë bisht për t'i nxjerrë materialet shfajësuese menjëherë në momentin kur prokuroria e ka një dokumentacion të tillë në duar. Ne sugjerojmë që, përveç ta lidhim atë me kontrollime shtesë të synuara, ajo çfarë kërkojmë ne është që kontrollimet e synuara të cilat i ka përmendur prokuroria, pra ato të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me listën e dëshmitarëve dhe listën e

provave materiale, pra në qoftë se këto kontrollime lidhen me materialet shfajësuese, duhet që materialet shfajësuese të na vihen në dispozicion menjëherë”, ka thënë ai.

Ndërsa prokuroria ka thënë se mbrojtja po e keqpërfaqëson natyrën e detyrimit sipas rregullës 103. Sipas prokurorisë, kontrollimet janë duke u kryer dhe nuk përjashtohet mundësia që mund të ketë kontrolle të reja gjatë procedurës. ZPS-ja e ka kundërshtuar caktimin e një afati për nxjerrje të tilla, duke thënë se kufizimi i prokurorisë në këtë aspekt nuk është në interes të askujt.

Ben Emmerson, avokati i Veselit, deklaroi se kanë përpara afatin e dorëzimit të dosjeve paraprake dhe kanë ndër mend të mbetet afat i pandryshuar. “Është pika që ndikon në zhvillimin e mëtejshëm të procedurave. Nuk duam të kërkojë zgjatje e afatit sepse prokuroria nuk ka përbushur detyrimet e veta të nxjerrjes së materialeve. Ajo që është problem akut lidhur me materialet e rregullës 107 është se aty janë përfshirë materialet e rregullës 103, por aty mund të jenë përfshirë edhe përzjerje materiale apo të ndryshme që mund të jenë të rëndësishme së

konsiderueshme për trupin gjykues që do të caktohet në këtë çështje”, tha ai tutje.

Ai tha se kolektivisht kanë bërë parashtrim për nevojën e identifikimit, se cilat prova janë nga burime të korruptuara dhe të dyshimta dhe që lidhen me Serbinë. “Ky është qëndrimi ynë sa iu përket palëve në konflikt, por këto materialet janë të rëndësishme pasi janë nga palë që nuk kanë qenë drejtpërdrejt të përfshira në konflikt. Siç e kemi parashtruar me shkrim, sasia e materialeve për të cilat ende nuk është marrë autorizim dhe ende nuk janë lëshuar është rreth 400 dokumente. E kemi të qartë çfarë ndikimi ky lloj dokumentacion mund të ketë, dokumentacion që është nga burime qeveritare apo ndërqeveritare dhe mund t'i japë njëfarë forme çështjes”, tha ai tutje.

Sipas tij, materialet kyçe ende nuk i janë nxjerrë mbrojtjes. “Nëse dorëzohen dosjet në fillim të tetorit, mbrojtja do të jetë e dëmtuar nga vetë fakti që prokuroria nuk do të mund t'i përbushë detyrimet e nxjerrjes. Nuk mund të ndodhemi në një situatë kur mbrojtja duhet të bëjë kërkesa për dorëzimin e një dosjeje paraprake të ndryshuar

Çitaku: Qytetarët në luftë për ekzistencë, Kurti në 100 ditët e fundit, 45 i kalon jashtë vendit

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Nënkrjetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, i ka bërë thirrje kryeministrit Kurti që të rikthehet në Kosovë dhe të merret me shqetësimet dhe problemet e qytetarëve, të cilët sot janë në luftë për ekzistencë. Çitaku ka thënë se në krizën më të madhe ekonomike të Kosovës, kryeministri Albin Kurti në 100 ditët e fundit i ka kaluar 45 ditë jashtë vendit pa arritur asnjë rezultat. "Në këtë kohë kur shumica e familjeve kosovare po ballafaqohen me krizën më të madhe ekonomike, me rritjen enorme të çmimeve të produkteve bazike për jetesë, kryeministri i vendit, i cili do të duhej të ndërmerre hapa për tejkalimin e krizës, ka zgjedhur të ikë nga Kosova e të kalojë kohë nëpër

vizita, të cilat, thënë më së buti, do të mund të quheshin studimore", ka thënë Çitaku në një konferencë për medie. Nënkrjetarja e PDK-së ka thënë se kryeministri Albin Kurti nuk po qeverisë vendin, përkundrazi, ai po ik prej përgjegjësisë që e ka marrë nga qytetarët. "Nga njoftimet publike të qeverisë, vetëm gjatë tre muajve të fundit, kryeministri Kurti ka qëndruar 45 ditë jashtë Kosovës, pa sjell asnjë sukses të vetëm nga këto vizita të stërzgatura dhe tërësisht atipike për një kryeministër në detyrë. Gjysmën e kohës në 100 ditët e fundit kryeministri Kurti e ka kaluar jashtë Kosovës", ka shtuar nënkryetarja Çitaku. Kryeministri Kurti edhe mandatin qeverisës e ka nisur jashtë Kosovës, duke bërë

fushatë zgjedhore në Shqipëri. Sipas Çitakut, kjo është një zgjedhje që kryeministri Kurti e ka bërë nga fillimi i mandatit e deri sot - duke abstenuar nga qeverisja dhe ballafaqimi me sfidat dhe problemet e qytetarëve. "Në këtë periudhë kohore qytetarët e braktisur nga qeveria, me rritje enorme të çmimeve, me energji deri trefish të shtrenjtuar, me inflacion mbi 14 për qind, zgjidhje po e shohin ikjen nga Kosova", ka thënë nënkryetarja e PDK-së. Ajo ka shtuar se ishin alarmante shifrat e publikuara ditë më parë nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, ku 42 mijë qytetarë tanë kishin lënë Kosovën vetëm në vitin e kaluar, ndërsa mijëra të tjerë presin çdo ditë para ambasadave për t'i caktuar terminet për vizë pune jashtë

Kosovës. "Qytetarët e Kosovës e kanë votuar Albin Kurtin dhe Vetëvendosjen më 14 shkurt duke besuar në premtimet e tyre. Por, ajo çka po shohin është se inflacion më të madh se çmimet, kanë pësuar premtimet e kryeministrit", ka thënë ajo. Çitaku ka potencuar edhe shqetësimet e kryetarëve të komunave të Kosovës të cilët, pa dallim partie, po ankohen se kjo qeveri i ka bllokuar të gjitha projektet, duke mos ndarë buxhet për realizimin e projekteve komunale. "E ka bllokuar për muaj të tërë OShP-në dhe kësaj, i ka bllokuar të gjitha investimet kapitale anekënd Kosovës. Në vend se të ndërmarrë vendime që iu përkasin kompetencave qeveritare, duke hequr TVSh-në dhe akcizën, kryeministri Kurti po merr vendime arbitrare në

fushën e ekonomisë duke ndërhyrë në caktimin e çmimeve", ka thënë Çitaku. Në fund, Çitaku ka thënë se, krahas papërgjegjësisë totale në qeverisjen e brendshme, qeveria aktuale po tregohet tërësisht jotransparente edhe për procesin e dialogut. "Nga ndërmjetësuesi i Bashkimit Evropian dëgjuam se qenkan gati katër marrëveshje të reja. Ne kërkojmë të njoftohemi nga kryeministri në abstenim, Kurti, ose nga kryeministri faktik, Bislimi, se cilat janë këto marrëveshje? Për çka bëhet fjalë. Dialogu me Serbinë nuk bën të degradojë në noterizim të marrëveshjeve teknike paraprake, duke lënë në margjina, e jo në qendër, njohjen reciproke", ka përfunduar nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku.



në dritën e materialet që do të jepet me vonesë nga prokuroria. Kërkoj që këtë afat aktual ta ndryshoni në një afat për dorëzimin e dosjes paraprake

provizore, pra me një formulim të tillë", tha Emmerson. Aktakuza ndaj Thaçit dhe të tjerëve lidhur me pretendimin për krime lufte është konfirmuar

më 26 tetor 2020, ndërsa në paraqitjet e tyre të para në Dhomat e Specializuara në Hagë ata janë deklaruar të pafajshëm. Ata po qëndrojnë në paraburgim

në Hagë prej nëntorit të vitit 2020. Më 29 prill Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar një aktakuzë të ndryshuar ndaj

Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, ku pretendon se të akuzuarit kanë kryer krime lufte në Gjilan, Budakovë e Semetishtë.

Reagim i KMDLNj-së

Pse familjarët e pengjeve të Gjykatës Speciale nuk pajisen me vizë afatgjatë?!



Gjatë takimeve me familjarë të shtetasve kosovarë, të gjithë shqiptarë që po mbahen peng në Gjykatën Speciale, njëri ndër problemet me të cilat po përballen këta janë vështirësitë për pajisje me viza, madje në disa raste edhe është refuzuar, pa dhënë asnjë shpjegim edhe dhënia e vizave. Po i njëjti problem është edhe për avokatët mbrojtës të cilët në shumicën e rasteve pajisen me viza aq kohë sa takojnë të mbrojturit e tyre e pastaj i nënshtrohen një përsëritje burokratike për riaplikim për viza të reja. Edhe familjarët, në jo pak raste pajisen me vizë afatshkurtër e që, përkundër faktit se nuk paguajnë për vizë, domosdoshmërisht i nënshtrohen një procesi të lodhshëm për riaplikim. Rasti i fundit e që sipas KMDLNj-së paraqet rast flagrant të shkeljeve të drejtave të njeriut është pamundësimi i prindërve të presidentit Hashim Thaçi të qëndrojnë më gjatë në vizita për faktin se ishin të pajisur me një vizë treditëshe

që paraqet dhunim flagrant i të drejtave të njeriut aq më parë që për shkak të moshës është pikëpyetje e madhe nëse do të kenë rastin që përsëri të vizitojnë birin e tyre të arrestuar. KMDLNj edhe më herët gjatë raportimit MD-së e ka vënë theks të veçantë në këtë problem që është e drejtë e njeriut mirëpo, përjashtuar disa raste, gjendja nuk është përmirësuar. Shteti i Holandës, si shtet pranues ku edhe është selia e kësaj Gjykate ndërkombëtare e që po kontrabandohet si pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, kishte marrë detyrim të lehtësojë pajisjen me viza ndërsa, në një deklaratë para një muaji kanë deklaruar se më Holanda nuk do të lehtësojë procesin e pajisjes me viza për familjarët apo mbrojtësit e të akuzuarve, tash pengje të Gjykatës Speciale. Askush me vullnetin e vet nuk do të pranonte që të dërgohej në burg mijëra kilometra larg vendbanimit dhe familjes

ndërsa, ata që e kanë marrë këtë vendim është dashur dhe duhet të marrin përgjegjësi për pajisje me vizë afatgjatë, si për familjarët e ngushtë ashtu edhe për ekipin mbrojtës. Ashtu siç po veprohet, Gjykata Speciale, ndonëse po thirret në standardet më të larta të respektimit të drejtave të njeriut siç janë Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregullat e Nelson Mandelës si standard më i lartë i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e të burgosurve, në fakt, po e bënë të kundërtën, po i shkel të drejtat e njeriut. Me këto rregulla parashihet që personi i privuar nga liria të jetë sa më afër familjes dhe vendit ku jeton (akomodim për ruajtje të shëndetit social) kurse, në raste speciale siç është ky, të burgosurit duhet të kenë lehtësira speciale në realizimin e të drejtave që iu takon e që nuk po bëhet. KMDLNj, gjithmonë ka propozuar që familjarët të pajisen me viza afatgjate sikur

edhe avokatët. Familjarët e ngushtë dhe mbrojtësit duhet të pajisen me pasaporta zyrtare për aq kohë sa zgjatë procesi para kësaj Gjykate. Çfarë kuptimi ka të pajisen me pasaporta zyrtare një berber apo rrobaqepës fundesh e mos të pajisen familjarët dhe mbrojtësit e të akuzuarve?! Të drejtat e njeriut nuk durojnë trajtim dhe standarde të dyfishta. Ato rregullohen me dokumente kombëtare dhe ndërkombëtare që i rregullojnë këto të drejta dhe të gjitha shtetet që i ratifikojnë këto dokumente marrin detyrim për respektimin dhe zbatimin e tyre. KMDLNj është edhe kundër vizitave, të ashtuquajtura humanitare kur një të akuzuari i pamundësohet pjesëmarrja në varrim ndërsa, pas disa ditësh, nën përcjellje dhe kushte turpëruese shoqërohen t'i vizitojnë varret të cilat mund t'i vizitojnë edhe pasi të kthehen në Kosovë! Çfarë humanizmi është t'i vizitoni varret e mos të keni të drejtë t'ia

jepni lamtumirën e fundit prindit apo familjarit të ngushtë?!

KMDLNj është kundër vizitave të shumta, shumica e të cilave bëhen për përfitime politike dhe materiale siç po e bëjnë institucionet, sepse nuk janë të sinqerta dhe nuk po ndikojnë aspak në përmirësimin e trajtimit të tyre siç është pajisja me viza afatgjate. Institucionet nuk mund të deklarohen publikisht me deklarata që e paragjykojnë fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarve sepse do të ishte ndërhyrje në punën e kësaj Gjykate, e tillë dhe diskriminuese që është por se mund dhe duhet të kërkojnë që të krijohen një mekanizëm monitorues që monitoron kushtet fizike dhe që e monitoron procesin gjyqësor! Qartazi, Komiteti

Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, që ka mandat ekskluziv për monitorim nuk ka as vullnet e as kohë ta bëjë monitorimin e përhershëm të drejtave të njeriut të të akuzuarve kurse Avokati i Popullit i kësaj Gjykate është post koti i cili në asnjë rast nuk i ka trajtuar pozitivistisht kërkesat e të akuzuarve.

Kuvendi i Kosovës duhet ta caktojë një seancë në të cilën do të vendoset nëse kjo Gjykatë është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës apo, në të kundërtën duhet të deklarohet botërisht se kjo Gjykatë Speciale është e Kosovës po aq sa është e Bangladeshit dhe ta heqë çdo përgjegjësi për shkeljet flagrante që po i bënë kjo Gjykatë. Nëse me Marrëveshje e sidomos me aneks marrëveshje i është bartë i tërë autoriteti vendimmarrës kësaj Gjykate duke e zhveshur Kosovën 100% nga vendimmarrja, mbikëqyrja dhe shtrirja e sovranitetit juridik, deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk duhet të jenë shoqëruar të verbër të shkeljeve të drejtave të njeriut që po i bënë kjo Gjykatë e cila, krahasuar me Tribunalin e Hagës për Krime Luftë për ish-Jugosllavinë po del të jetë një mekanizëm shumë më represiv sa i përket respektimit të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria.

Policia parandalon ngasësit e automjeteve nën ndikim të alkoolit

MITROVICË, 13 KORRIK (ER) - Masat dhe veprimet policore për zbatim të planit operativ "Sezoni veror 2022" janë duke vazhduar dhe po realizohen në fusha të ndryshme. Pjesë e këtyre veprimeve parandaluese dhe sensibilizimi janë edhe aktivitetet e shtuara në trafikun rrugor në parandalimin e ngasjes së mjetit nën ndikimin e alkoolit.

Në zonën e përgjegjësisë së Drejtorisë Rajonale në Mitrovicën e Jugut, në të gjitha akset rrugore do të shtohen kontrollet, me theks të veçantë për pjesëmarrësit në trafik të cilët drejtojnë automjetet nën ndikim të alkoolit. Përveç kontrolleve, matjeve me alkool-test dhe masave ndëshkimore, policia për pjesëmarrësit në trafikun rrugor po shpërndan fletushka

me porosi vetëdijësi/sensibilizimi për rrezikun dhe pasojat e ngasjes së mjetit nën ndikim të alkoolit. Policia u bën thirrje të gjithë pjesëmarrësve në trafikun rrugor, me qëllim që të mos rrezikojnë veten dhe pjesëmarrësit e tjerë, t'u përmbahen rregullave të përcaktuara me ligjin për sigurinë në trafik.



Petkoviqit sërish i ndalohej hyrja në Kosovë

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Petar Petkoviq sërish nuk është lejuar të hyjë brenda territorit të Kosovës për të vizituar disa fshatra në Gjilan dhe Leposaviq.

Pas kthimit nga pika kufitare, mediet serbe raportojnë se Petkoviq ka fajësuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe kërkon që me BE-në të merren vesh nëse duan ta vazhdojnë dialogun.

“Ardhja ime sot në Konçul është, para së gjithash, një mesazh për komunitetin ndërkombëtar i cili është qartazi i paaftë ose pretendon të jetë i tillë kur bëhet fjalë për Prishtinën dhe kur shikon me përçmim Albin Kurtin dhe Prishtinën, të cilët çdo ditë shkelin marrëveshjet që kemi arritur në Bruksel, duke përfshirë edhe marrëveshjen për

vizitat zyrtare”, ka thënë Petkoviq për mediet serbe. Shefi i Zyrës për Kosovën shton se vizitën e ka paralajmëruar me kohë dhe nuk e kupton refuzimin e saj nga autoritetet e Kosovës. Atij edhe gjatë së martës i është ndaluar vizita në Konçul dhe Leposaviq, ndërsa institucionet në Kosovë ende nuk kanë dhënë përgjigje për refuzimin.



Pas ndërprerjes së shërbimeve në Onkologji, Shqipëria i pranon pacientët nga Kosova

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 KORRIK - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka pranuar të mërkurën mbështetje nga ministrja e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë, Orgeta Manastirliu, për trajtimin e pacientëve nga Kosova me radioterapi. Me këtë rast, ministri Latifi falënderoi homologen për mbështetjen e dhënë për këta pacientë.

Në letrën e ministres Manastirliu thuhet se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë shpreh keqardhje për situatën e krijuar në Klinikën e Onkologjike të Shërbimit Spitalor të Kosovës dhe gjenden pranë në këtë situatë të krijuar si pasojë e kushteve atmosferike. “Bazuar në

bashkëpunimin e vazhdueshëm reciprok, por edhe në marrëveshjet e bashkëpunimit në fushën e Shëndetësisë, midis Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë, shprehim angazhimin tonë maksimal për ta krijuar mundësinë e trajtimit të pacientëve nga Kosova në njësinë tonë të Radioterapisë”, thuhet në letër.

Në vazhdim të letrës thuhet po përvijohet një plan i përbashkët pune në nivel teknik për të mundësuar plotësimin e nevojave të përcjella nga Shërbimi i Onkologjisë së Kosovës në përpunime me mundësitë e Shërbimit Onkologjik Tiranë sipas prioriteteve të përcaktuara nga specialistët e



dy vendeve dhe kapaciteteve të Shërbimit. “Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë ka nderin të

paraqesë edhe një herë konsideratën e saj më të lartë për Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe ta shprehë gatishmërinë e saj

për çdo ndihmë e komunikim në ditët në vazhdim”, përfundon letra mbështetëse e ministres Manastirliu dërguar ministrit Latifi.

Ambasadori i Izraelit në Holandë përgëzon Kosovën për hapjen e Ambasadës në Jerusalem



PRISHTINË, 13 KORRIK - Ambasadori i Republikës së Kosovës në Holandë, Dren Doli, është takuar me ambasadorin e Izraelit atje, Modi Ephraim.

Doli ka shkruar në “Twitter” se ka qenë një takim i shkëlqyer me ambasadorin

Ephraim, derisa kanë diskutuar për prioritetet e politikës së jashtme, sfidat e përbashkëta dhe rrugën për zgjerimin e bashkëpunimit në Holandë.

Për këtë takim ka reaguar edhe vetë ambasadori i Izraelit në Holandë, duke

thënë se ka qenë shumë i lumtur që është takuar me ambasadorin e Kosovës me të cilin kanë zhvilluar diskutime të frytshme.

Gjithatë Ephraim ka thënë se e ka përgëzuar Dolin për hapjen e ambasadës së Kosovës në Jerusalem.

Qeveria gjermane i dhuron FSK-së donacion në vlerë prej 405 mijë eurosh

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në takim atashen jorezident gjerman të mbrojtjes në Kosovë, nënkolonel Franz-Josef Nolte, me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen për donacion me Republikën Federale të Gjermanisë për dhurimin e kamionëve për auto-shkollën e FSK-së. “Falënderim dhe mirënjohje e lartë për Qeverinë gjermane e cila dhuroi

donacionin e ri për FSK-në në vlerë prej 405 mijë euro. Sot pata kënaqësinë të pres në takim atashen jorezident gjerman të mbrojtjes në Kosovë, Nënkolonel Franz-Josef Nolte, ku së bashku me Kolonel Cakajn, nënshkruam Marrëveshjen për Donacion me Republikën Federale të Gjermanisë për dhurimin e kamionëve për auto-shkollën e FSK-së, vlera e së cilës është 405 mijë euro”, ka shkruar Mehaj në llogarinë e

vet në “Facebook”.

Ai ka shprehur falënderimin dhe mirënjohjen e lartë për mbështetjen e përhershme të shtetit gjerman për të gjitha të arriturat e deritashme të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. “Vazhdojmë angazhimin në avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit bilateral edhe në të ardhmen të nivel të ministrive dhe forcave të të dy vendeve tona”, ka shkruar Mehaj.



KEDS-i po bën mirëmbajtje intensive të rrjetit gjatë kësaj vere

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë të rrjetit distributiv për dimër, KEDS-i ka bërë me dije se ka përgatitur një plan intensiv të mirëmbajtjes së linjave të tensionit të mesëm. Përmes realizimit të këtij plani parashihet që të ulet numri i ndërprerjeve në rrjet nga faktorët atmosferikë apo mbingarkesat eventuale. "Punëtorët tanë janë duke e bërë pastrimin e traseve në tërë territorin e vendit, pastaj ndërrimin e aseteve të dëmtuara dhe përforcimin e rrjetit aty ku paraqitet e nevojshme. Gjatë kohës kur intervenohet nëpër dalje,

ndërprerjet mund të jenë disaorëshe, pasi duhet të revizionohet komplet traseja e linjës përkatëse dhe kjo merr kohë. Pasi që është e pamundur që të punohet nën tension për shkak të rrezikut, atëherë ndërprerjet e planifikuara janë të domosdoshme", ka njoftuar KEDS-i, duke shtuar se nuk do të ketë shumë ndërprerje të energjisë elektrike. "Kjo varet edhe nga gjendja e linjës. Objektivi ynë është që mirëmbajtja të jetë e standardeve më të larta dhe, pos faktorëve atmosferikë, daljet t'i përballojnë edhe mbingarkesat eventuale sa më

shumë të jetë e mundur. Prandaj, nëse një dalje është në gjendje më të rënduar, atëherë mirëmbajtja e plotë merr më tepër kohë. Kjo mirëmbajtje po bëhet pikërisht gjatë verës, kur kërkesa është më e ulëta, në mënyrë që të ketë ndikim sa më të vogël në përditshmërinë e konsumatorëve dhe benefitet e saj të jenë maksimale pikërisht në kohën kur u nevojitet më së tepërmi atyre, pra gjatë dimrit", ka njoftuar KEDS-i, duke njoftuar se është i përkushtuar ta japë maksimumin për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative për të gjithë konsumatorët.



Qeveria paralajmëron masa për prodhimet bazë

PRISHTINË, 13 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës, Rozeta Hajdari, ka paralajmëruar se janë duke shqyrtuar mundësinë për marrjen e masave ligjore për prodhimet bazë në mënyrë që t'i mbrojnë konsumatorët.

Çmimi tavan apo caktimi i marzhës janë dy mundësitë që janë duke u shqyrtuar.

Prodhimet esenciale për konsumatorin janë gruri, mielli, buka, vaji, vezët, pastat, qumështi, kripa, detergjenti e të tjera. "Se cila masë do të vendoset për produktet bazike do të vendoset shumë shpejt, vetëm varet nga analiza e situatës", ka thënë Hajdari në një konferencë për medie më 13 korrik.

Hajdari ka shprehur shqetësimin për ngritjen e çmimit të bukës në disa qytete të Kosovës që, sipas saj, po ndodh në kohën kur importi i çmimit të miellit dhe grurit është liru për shtatë për qind në krahasim me muajin maj.

Ditët e fundit në disa qytete të Kosovës çmimi i bukës është shtrenjtuar nga 40 deri në 60 centë. "Me këtë situatë, ne në vazhdim të analizës nga rrjeti i operatorëve të shitësve me pakicë, shohim që kemi një dallim tepër të lartë. Marzha tregtare e fitimit ka qenë nga 4 deri 19 për qind", ka thënë ajo. Edhe kryetari i Shoqatës së



Mullisëve të Kosovës, Bashkim Zejnullahu, ka kërkuar që të mos spekulohet me çmimet. Ai ka thënë se në tregun e Kosovës aktualisht ka sasi të mjaftueshme të grurit dhe miellit dhe nuk ka arsye për shqetësim dhe ngritje të çmimeve.

Në Kosovë ka filluar procesi i korje-shirjes. Ministria Hajdari konsideron se nga korjet-shirjet e grurit Kosova do të

sigurojë deri në 70 për qind të kërkesave të qytetarëve.

Qeveria e Kosovës muajin e kaluar ka marrë vendim për caktimin e çmimit tavan për derivate të naftës.

Kosova është përballur me rritje çmimesh të produkteve dhe shërbimeve nga fundi i vitit të kaluar, kryesisht për shkak të çrregullimeve në furnizime që ka shkaktuar pandemia e koronavirusit. Hov më të madh

atyre u ka dhënë pushtimi rus i Ukrainës, i cili ka nisur në fund të shkurtit.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), inflacioni në muajin qershor të këtij viti ka arritur 14.1 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Sipas çmimeve ditore për prodhimet bazë të publikuara më 12 korrik 2022 nga ASK-ja, një kilogram miell në treg

aktualisht shitet për 0.79 euro, një litër vaj 2.93 euro, buka e zakonshme 0.50 euro, një litër qumësht 1.10 euro, kurse 30 kokra vezë shiten për 3.90 euro. Sipas ASK-së, në muajin qershor të vitit të kaluar një kilogram miell ka kushtuar 0.52 euro, një litër vaj 1.56 euro, një bukë e zakonshme 0.46 euro, një litër qumësht 0.91 euro, kurse 30 kokra vezë kushtonin 1.92 euro.

Dogana konfiskon 675 litra vaj, kontrabandë nga Serbia

PRISHTINË, 13 KORRIK (ER) - Dogana e Kosovës ka konfiskuar mallra të kontrabanduara me origjinë nga Serbia në një automjet në Mitrovicë.

Bëhet fjalë për 675 litra vaj ushqimor të cilat kanë qenë të ngarkuara në një automjet të

dyshimtë që është identifikuar gjatë lëvizjes nga njësitet e Antikontrabandës së Doganës së Kosovës në Mitrovicë. "Në regjionin e Mitrovicës njësitet e Antikontrabandës së Doganës së Kosovës kanë identifikuar një automjet të

dyshimtë dhe me rastin e ndalimit janë gjetur mallra të kontrabanduara me origjinë nga Serbia, respektivisht 675 litra vaj ushqimor. Mallrat dhe automjeti janë sekuestruar si dhe ka filluar procedura kundërvajtëse", ka njoftuar Dogana.



Lufta e Parë Botërore dhe mitologjia e rrezikshme e vrasjes së Franc Ferdinandit



Nga Paul MILLER-MELAMED

“E shtëna e parë e Luftës së Madhe” e cilëson historiani i famshëm A.J.P Tejlor në librin e tij “Lufta e Parë Botërore: Një histori e ilustruar” (1963). Ajo u realizua nga një i ri serbo-boshnjak i quajtur Gavrilo Princip në Sarajevë më 28 qershor 1914. Dhe “viktimat e para” të asaj lufte, ishin Arkiduka Franc Ferdinand, trashëgimtari i fronit të Austro-Hungarisë (Monarkia e Habsburgëve) dhe gruaja e tij, dukesa e Hohenbergut. Natyrisht, kjo është një metaforë. Pasi nuk pati menjëherë luftë kur ndodhi atentati famëkeq i Sarajevës, dhe nuk do të kishte edhe për muajin pasardhës. Për më tepër, nëse duhet fajësuar dikush për shpërthimin e luftës në korrikun e vitit 1914, atëherë ata janë udhëheqësit e Fuqive të Mëdha të Evropës, dhe jo fshatari Gavrilo Princip.

E megjithatë, është shumë e lehtë të supozosh një lidhje sinonimike midis vrasjes së Arkidukës dhe Luftës së Madhe. Është pikërisht ky supozim, ai që e bën kaq magjepsës studimin e atentatit të Sarajevës. Shumica e raportimeve mbi vrasjen e Sarajevës, qofshin botime shkencore apo raportime gazetash, përipiqen aq shumë për ta bërë aktin si

përmbushës të trashëgimisë së tij, saqë shpesh e shtrembërojnë dhe nxjerrin shumë nga konteksti.

Dhe ky është një problem më i madh se një metaforë e zgjuar, është një mit. Në dallim nga përshkrimet popullore të “vrasësve terroristë” të regjur më kësi punësh, të rinjtë boshnjakë ishin tërësisht amatorë. Ata kishin mësuar vetëm kohët e fundit të gjuanin me armë apo të ndiznin një granatë.

Nga mjedisi i “i dhunshëm” ballkanik dhe deri tek ekzekutimi i nëmujshtëm, vrasja politike e Ferdinandit është manipuluar duke u shndërruar në një ngjarje gati mitologjike. Kjo ngjarje duhet të ndodhte me siguri në këtë “zonë të egër të Evropës së qytetëruar”, shkruante një historian në vitet 1930, duke ndjekur një traditë të gjatë dhe të vazhdueshme të stereotipizimit të Ballkanit si të rrezikshëm dhe të padisiplinuar, si primitiv dhe të prirur për luftë. Gati 80 vjet më vonë, një studiues tjetër e përshkroi vrasjen si një “ngjarje të rastësishme”. Sigurisht, Sarajeva nuk ishte Vjena, edhe pse që kur e mori nën administrim në vitin 1878, Austro-Hungaria kishte investuar burime të mëdha në zhvillimin e Bosnjes. Dhe pasi e aneksoi atë në mënyrë të njëanshme në vitin 1908, vetë monarkia e Habsburgëve iu afrua shumë provokimit të një

fuqie tjetër me ndikim në Ballkan, Perandorisë ruse, duke rrezikuar një luftë më përmasa kontinentale.

Kur tensionet u zbutën dhe kur kajzeri i Habsburgëve vizitoi provincat e kontestuara në majin e vitit 1910, një vrasës e ndoqi atë deri në Sarajevë. Vetë Franz Ferdinand u paralajmërua të mos shkonte në Bosnje për inspektime ushtarake në vitin 1914, për shkak të tentativave të shumta për vrasje në rajon.

Edhe në prag të parakalimit të tij në Sarajevë, Ferdinandi u paralajmërua nga zyrtarët boshnjakë dhe njerëzit në rrethin e tij për rreziqet e udhëtimit nëpër kryeqytet me një makinë të hapur, pikërisht në ditën e një feste kombëtare serbe. Ishte Vidovdani, ose Dita e Shën Vitit.

Nacionalizmi serb, është një tjetër pjesë e brutalitetit të supozuar ballkanik. Edhe pse kishte 1/10 e madhësisë dhe popullsisë së perandorisë Habsburgase, Serbia lakmonte provincat e saj sllave në jug, dhe mbi të gjitha Bosnjen. Princi dhe bashkëpunëtorët e tij ishin kryesisht serbë të Bosnjës, pra boshnjakë ortodoksë, jo qytetarë serbë.

Vërtet atentati u krye gjatë Vidovdan, por nuk ka asnjë provë që kjo kohë ishte e qëllimshme. Më shumë rëndësi për komplotistët kishte urrejtja e tyre e lindur për sundimin e

Habsburgëve, dhe jo dashuria e tyre e fortë për Serbinë e Madhe, e lëre më pastaj për socializmin, anarkizmin apo ndonjë ide tjetër dominuese në fundin e shekullit XIX-të.

Edhe më serioze dhe subversive janë akuzat, se forcat tinëzare nacionaliste brenda Serbisë planifikuan vrasjen dhe rekrutuan “kukullat” boshnjakë. Një organizatë “sekrete”, Dora e Zezë, ishte prapa komplotit të Sarajevës. Por sërish provat janë të pamjaftueshme. Dora e Zezë, ekzistonte vërtet dhe ishte një fraksion ushtarak vërtet kërcënues për qeverinë serbe. Por udhëheqësit e saj nuk ishin budallenj, dhe ata e dinin se një vrasje e pasardhësit të Habsburgëve, rrezikonte një luftë për të cilën Serbia ishte e papërgatitur. Vrasja e Sarajevës nuk “ndezi fitilin” e luftës së parë botërore. Përkundrazi, kjo e fundit u shkaktua nga një krizë diplomatike, të cilën udhëheqësit e Evropës së “qytetëruar” nuk arritën që ta zgjidhnin në mënyrë diplomatike.

Mund të ketë qenë vërtet një anëtar i “Dorës së Zezë”, ai që i ndihmoi vrasësit të gjenin armët dhe të stërviteshin me to në Beograd. Por kjo nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me organizatën, dhe lëre më pastaj me qeverinë serbe. As Austro-Hungaria nuk pretendoi diçka të tillë në ultimatumit e saj të 23 korrikut ndaj Serbisë.

Sipas një historiani, vrasja politike ishte një ngjarje që mbeti në mendjet dhe kujtimet e të gjithë bashkëkohësve, njësoj si 11 Shtatori 2001 ose vrasja e presidentit Xhon Kenedi për amerikanët. Në fakt, rrëfime të panumërta flasin për një apati dhe indiferencë relative në raport me këtë vrasje politike.

Sigurisht, ajo u konsiderua një tragjedi, por jo e përmasave të tilla, që siç i shkroi në mënyrë të frikshme nënsekretari i përhershëm britanik i shtetit në Ministrinë e Jashtme, Sër Artur Nikolson, ambasadorit të tij në Shën Petersburg, do të “çonte në pasoja të mëtejshme”. Ajo që “ndryshoi gjithçka” nuk ishin plumbat e një “heroi serb”, por një gabim historik nga ana e Evropës.


Së pari i Fuqive të Mëdha, që iu bashkuan ultimatumit të Austro-Hungarisë drejtuar Serbisë më 23 korrik. Në atë kohë, vrasja e Sarajevës po harrohej, sepse tek e fundit ajo ishte një epokë, në të cilën vrasjet politike ishin shumë të zakonshme. Ose siç shkroi një gazetë amerikane në atë kohë, kishte trashëgimtarë të tjerë austriakë për të zëvendësuar Arkidukën.

Shënim: Paul Miller-Melamed, lektor i historisë në Universitetin Katolik Papa Gjon Pali II në Lublin, Poloni, dhe në Kolegjin Mekdeniel në SHBA.

Marrë me shkurtime nga “History Extra” – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-DENISAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Ermal Krasniqi merr përgjegjësinë e eliminimit të Ballkanit nga Liga e Kampionëve

SUHAREKË, 13 KORRIK - Ermal Krasniqi është një nga lojtarët më të mirë në skuadrën kampione të Kosovës në futboll, Ballkani. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka marrë përgjegjësinë e eliminimit të skuadrës së tij nga Liga e Kampionëve.

Ballkani ka mbetur baras 1-1 në ndeshjen e parë kundër Zargilist, kurse në ndeshjen kthyes humbi me rezultat 1-0. "Zhgënjimi nga mossauesi nga rrethi i parë kualifikues i Ligës së Kampionëve kundër ekipit Zhalgiris është shumë i madh si nga ekipi në tërësi, ashtu edhe në aspektin personal. Unë në veçanti, duke i ditur pritshmëritë tuaja që keni pasur ndaj ekipit e ndaj meje, duke u bazuar në një sezon që porsa mbaruam me sukses, duke u shpallur kampion për herë të parë në histori të klubit, ndiej përgjegjësi të konsiderueshme për këtë eliminim, duke i marrë për bazë rastet që më janë dhënë



gjatë ndeshjes e që, për fat të keq, nuk arrita t'i konkretizoj, pavarësisht që askush nuk do të donte më shumë se unë", ka shkruar Krasniqi. "Udhëtimi ynë vazhdon në Evropë dhe ju

premtoj që sukseset për ne nuk mbarojnë këtu. Do të vazhdojmë më të uritur e më të motivuar që ta përfundojmë këtë kampanjë evropiane me sukses historik në fund", ka shtuar Krasniqi.

Batatina, tifozëve shqiptarë: Të dominojë brohoritja 'O sa mirë me qenë shqiptar'

PODUJEVË, 13 KORRIK - Tifozët nga treva të ndryshme shqiptare do t'ia mësyjnë Prishtinës për ndeshjen ndërmjet Llapit dhe Budućnostit, e vlefshme për rrethin e parë kualifikues të Ligës së Konferencës. Llapjanët nuk kaluan mirë në lojën e parë javën e kaluar pasi tifozët malazezë i fyen dhe i përleshën shqiptarët përmes banerëve dhe koreografive që i shfaqën në tribuna.

Tifozët e Budućnostit, "Varvari", e kanë paralajmëruar pjesëmarrjen edhe në stadiumin "Fadil Vokrri" përmes postimeve provokuese në rrjetet sociale. Nga ana tjetër, trajneri i Llapit, Tahir Batatina, ka njoftuar se deri tash 10 mijë bileta janë shitur, ndërsa numri i tyre mund të rritet deri të enjten. Po ashtu, trajneri llapjan e ka edhe një



lutje për tifozët shqiptarë, nga të cilët kërkon të dominojë brohoritja: "O sa mirë me qenë shqiptar". "Faleminderit gjithë kombit shqiptar për mbështetjen dhe kam një lutje nga të gjitha tifogrupet tona shqiptare që të dominojë brohoritja 'O sa mirë me qenë shqiptar'. Tash po e kuptoj vlerën e luftës kur isha 21 vjeç që po më kthejnë emocionet e

mëparshme nga lufta. Sapo më njoftuan se 10 000 mijë bileta janë shpërndarë te kombi shqiptar dhe qytetarët e Kosovës për këtë ndeshje. Përpara Llapi, Kosovë e Shqipëri, e të gjitha viset shqiptare kudo që janë", ka shkruar Batatina. Budućnosti e fitoi me rezultat 2-0 ndeshjen e parë, kurse ndeshja kthyes do të zhvillohet sonte me fillim nga ora 20:00.

SHKURT

'Blick': Ylli më i madh i Suedisë e ka emrin Kosovare

Cyrih, 13 korrik - Gazeta zvicerane "Blick" i ka kushtuar një artikull futbollistes së kombëtares së Suedisë, Kosovare Asllani. Në artikull vihet në pah se Asllani e ka prejardhjen nga Kosova. Ajo krahasohet edhe me futbollistin më të mirë të të gjitha kohëve që ka pasur Suedia, Zlatan Ibrahimović. "Blick" thotë se ylli më i madh i Suedisë e ka emrin Kosovare.

Ylli më i madh i Suedisë është Kosovare

Kujdes nga ky yll! Kosovare Asllani rrënjët i ka në Ballkan. Ajo është për çdo vajzë futbolldashëse në Suedi. Suedezet janë ekip i klasës botërore. Me futbollistet si Jane Caroline Seger, Fridolina Rolfö dhe Stina Blackstenius. Por, Kosovare Asllani është ylli më i madh i Suedisë. Ajo shënon gola dhe vendos për ndeshjet. Ashtu sikurse në fitoren 1:0 kundër Holandës, kur ajo godet Nouwen-in dhe më pas mban ia asiston topin Anderssonit në mënyrë të përkryer. Jashtë, ajo është model për të gjitha vajzat që kanë migruar në Suedi. Ajo ka lindur në Kristianstad një vit pasi prindërit e saj u larguan nga vendi i tyre me dy vëllezërit e motrat e saj dhe emigruan në Suedi më 1988. Emri i saj Kosovare, është një kujtim për atdheun e prindërve të saj.

Zemra e saj iu përket të dy vendeve

Fakti që Kosovarja fitoi medaljen e argjendtë olimpikë me Suedinë 27 vjet më vonë – në Rio 2016, ku Kosova mori pjesë për herë të parë si shtet i pavarur – është një histori e bukur. "Jam shumë krenare që luaj për Suedinë dhe e kam Kosovën në zemër. Kjo medalje nuk është vetëm për Suedinë, por edhe për Kosovën. Zemra ime iu përket të dy vendeve", pati thënë ajo për Fifa.com. Ajo, gjithashtu, ka bërë tatuazh shqiptonjën dykrenare. Asllani është prej kohësh e pëlqyera e tifozëve në Suedi, shkruan "Blick.ch".

Krahasimi me Ibrahimovićin

Kosovare Asllani krahasohet me yllin suedez të futbollit, Zlatan Ibrahimović. Asllani për këtë pati thënë se nuk dëshiron të krahasohet me të dhe me asnjë futbollist, pasi nuk kanë ngjashmëri mes vete. Ajo deri më tani ka arritur të shënojë 43 gola në 160 ndeshje.

Fiorentina shpreh interesim për Kumbullën

Firencë, 13 korrik - Skuadra e Fiorentinës ka hartuar një listë të gjatë me emrat e mundshëm që mund ta zëvendësojnë Nikola

Milenkovićin. Sipas asaj që raporton gazeta "La Nazione", për momentin Robin Le Normand dhe Marash Kumbulla janë dy

lojtarët më të pëlqyer. Gjithsesi me ta do të bisedohet vetëm në rast se Interi dhe Juventusit do të arrijnë që ta kompletojnë

transferimin e serbit. Kumbulla mund ta zgjedhë ekipin violë pasi te Roma nuk është se e ka formacionin e garantuar.



Vetteli sezonin e ardhshëm kalon te McLarenit

WOKING, 13 KORRIK - Piloti gjerman Sebastian Vettel, i cili garon në Formula 1 me skuadrën e Aston Martinit, pritet të transferohet te rivalët e McLarenit në sezonin e ardhshëm. Lajmi i bujshëm vjen nga Anglia. Katër herë kampioni

i botës do ta zërë vendin e ish-shokut të skuadrës te Red Bull, australianit Daniel Ricciardo. Duket se McLarenit nuk do t'i prishë kontratën që ka me australianin (skadon në vitin 2023), që këtë sezon po paraqitet dobët. Mes kandidatëve për ta

zënë vendin e Ricciardos është edhe Alexander Albon, por duket se Vetteli është i pëlqyeri. Përvoja e tij dhe katër titujt kampionë bote e favorizojnë në këtë garë. Duket se edhe Vetteli dëshiron të nisë një aventurë të re, pasi ka mbetur i zhgënjyer nga paraqitja

e Aston Martinit, që nuk ka dhënë atë që pritej në këto dy sezone që janë së bashku. Gjithsesi, te McLarenit do t'i testojnë edhe disa pilotë të rinj (Colton Herta, Andreas Seidl e Oscar Piastri) para se të marrin një vendim.



'El Nacional': Messi kërkon të rikthehet në Barcelonë

BARCELONË, 13 KORRIK - Lionel Messi raportohet se është i interesuar të rikthehet në Barcelonë për shkak të rritjes së ndikimit të Kylian Mbappes te PSG-ja. Pasi u largua papritur nga Barça verën e kaluar, Messi nënshkroi një marrëveshje dyvjeçare me parisienët, me një opsion për një vit tjetër. "El Nacional" shkruan se Messi ka kontaktuar me trajnerin e Barcelonës, Xavi, për ta komunikuar dëshirën e tij për t'u rikthyer në klub. Statusi në rritje i Mbappes në klub duket se e ka bërë shumë të vështirë jetën për 35-vjeçarin, i cili duhet të kënaqet me një rol më të vogël. Me një marrëveshje të re, Mbappe mund të ndikojë në vendimet e klubit dhe rinovimi i fundit i Mbappes thuhet se ka ndezur xhelozitë dhe zili në dhomën e zhyshjes. Artikulli i "El Nacional" vë në dukje se shkarkimi i Mauricio Pochettino kishte një ndikim negativ në marrëdhëniet e



klubit me Messin. Për më tepër, Leo nuk është impresionuar nga rregullat strikte për lojtarët që ka vendosur trajneri i ri Christophe Galtier. Përveç kësaj, Messi është i pakënaqur me pozicionin e PSG-së në lidhje me të ardhmen e

Neymarit. "Le10Sport" raportoi më parë se shtatë herë fituesi i "Topit të Artë" dëshiron ta zgjasë qëndrimin e tyre së bashku në Paris. Megjithatë, nuk dihet nëse mendimi i tij do të ndikojë në dëshirën e klubit për ta hequr qafe brazilianin.

Fury: Duelet me Wilderin më bindën të tërhiqem nga sporti

LONDËR, 13 KORRIK - Boksieri britanik Tyson Fury, kampion bote në peshën e rëndë (WBC), ka folur edhe një herë për tërheqjen e tij nga sporti (32 fitore e 1 barazim në karrierë). Ai u shpreh se duelet ndaj amerikanit Deontay Wilder kanë ndikuar te ky vendim. Sfidat e tretë mes tyre, ku ra dy herë në tapet brenda katër rundesh, e kanë bindur se është koha për t'u larguar. Fury bëri me dije se kishte pësuar një tronditje dhe disa gjysmë "gunga" në kokë nga grushtet e Wilderit. "Unë kam 13 vjet që jam boksier profesionist, kam shkuar në të gjithë botën dhe jam ndeshur me luftëtarët më të mirë në botë. Me amerikanët, afrikanët, gjermanët dhe fitova ndaj të gjithëve. Të gjithë i munda", ka thënë Fury. Ai kujton çastet e para kur nisi të mendonte të tërhiqej nga sporti.



"Pas duelit të tretë me Wilderin kisha gunga në pjesën e pasme të kokës si grushtet. U trondita, pasi nuk mbaja mend asgjë. Po mendoj se kishte ardhur koha të tërhiqesha", ka shtuar Tyson Fury për "Daily Star". "Ka shtatë

miliardë njerëz në botë. Vetëm mendoni për këtë numër. Shtatë miliardë njerëz dhe unë jam kampioni i peshave të rënda në botë, i pamposhtur. Jam numri një. Nga të gjithë ata njerëz, unë jam më i miri", ka deklaruar Fury.

SHKURT

Marku nga 'Air Albania' pret me padurim duelin e madh më 25 gusht

Edhe pse ende nuk e ka zbuluar kundërshtarin për duelin e 25 gushtit në "Air Albania", boksieri shqiptar Florian Marku po bëhet gati për këtë sfidë, të cilën e quan madhështore. "Sot pashë nga afër stadiumin që do të ndeshem më 25 gusht. Më rrëqethet mishi kur mendoj se do të ketë mijëra shqiptarë këtu që do ta bërtasin emrin tim. Ju pres të gjithëve për një natë madhështore", ka shkruar Marku.

Raphinha nga Leeds kalon te Barça

Barcelona ka konfirmuar se ka arritur marrëveshje për transferimin e Raphinhas. Skuadra katalane përmes "Twitter" bëri me dije për arritjen e marrëveshjes me skuadrën e Leeds Unitedit. Barça dhe Leeds janë pajtuar që anësori brazilian t'i bashkohet skuadrës nga "Camp Nou". Në njoftimin zyrtar të klubit nuk bëhet me dije shuma e paguar për kartonin e tij. Lojtari tashmë mbetet vetëm t'i finalizojë testet mjekësore te klubi.

Sterling paralajmëron largimin nga City: Erdha si 20-vjeçar, po largohem si burrë

Raheem Sterling ka konfirmuar se po largohet nga Manchester City. Reprzentuesi anglez pritet t'i bashkohet Chelseat. Sulmuesi anglez ka kaluar shtatë sezone me "Qytetarët", duke bërë 337 paraqitje, duke shënuar 131 gola dhe duke fituar 11 tituj. "Shtatë sezone. Njëmbëdhjetë trofe të mëdhenj. Një jetë kujtimesh. Për të gjithë të përfshirë në Manchester City, respekti im për ju nuk mund të jetë më i madh. Çfarë udhëtimi ka qenë. Jam mirënjohës për uljet dhe ngritjet. Pasi që janë uljet dhe ngritjet që ndonjëherë kanë testuar forcën dhe vendosmërinë time. Dhe më kanë mundësuar të qëndroj këtu para jush si versioni më i mirë i mundshëm i vetes. Kam mbërritur në Manchester si një 20-vjeçar, sot largohem si burrë. Ka qenë nder ta vesh fanellën e Manchester Cityt", ka shkruar Sterling.

Dzeko refuzon ofertën e Juventusit

Sulmuesi Edin Dzeko refuzoi një transferim të mundshëm në Juventus gjatë fundjavës pasi është i vendosur të qëndrojë në Inter. Sipas ekspertit të transferimeve të "Sportitalia", Alfredo Pedulla, Juventus bëri një ofertë zyrtare për të nënshkruar me Dzekon gjatë 48 orëve të fundit, por sulmuesi e refuzoi atë. 36-vjeçari mbërriti verën e kaluar nga Roma praktikisht falas, në një marrëveshje me vlerë 1.5 milion euro plus bonuse të lidhura me performancën. Ai shënoi 17 gola dhe dha 10 asistime në 48 ndeshje në të gjitha garat sezonin e kaluar dhe ka kontratë deri në qershor 2023. Nuk është hera e parë që Dzeko lidhet me Juventusin, pasi loja e tij dhe niveli i punës e bëjnë atë një objektivi të pëlqyer për trajnerin Max Allegri.

Bayerni lejon Lewandowskin të largohet

Robert Lewandowskit duket se do t'i plotësohet dëshira që kishte për transferimin te Barcelona, me katalansit që

duket se janë pajtuar me Bayern Munchenin për polakun, i cili do t'i kushtojë klubit spanjoll 50 milionë euro.


Sipas raportimeve nga "RMC Sport", Barcelona ka vendosur t'i përmbushë pritshmëritë e Bayernit dhe të vendosë "në

pjatë" shumën e kërkuar prej 50 milionë eurosh për të lënë të lirë Lewandowskin. Në këto kushte pritet tashmë vetëm

finalizimi i detajeve të fundit, me polakun që pret me padurim të vendoset nën urdhrat e teknikut Xavi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT – SECRETARIAT

Bazuar në neni 11 paragrafi 4 Ligji Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës, Udhëzimin Administrativ të KGJK-së Nr.04/2016 të datë 04.11.2016 për Rregullimin e Procedurës së Rekrutimit për Punësimet me Kontrata të quajtura „Marrëveshje për Shërbime të Veçanta”, të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrime, në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (Nr. 01/2019) Për Ndarjen e Përgjegjësiave të SKGJK-së dhe të Gjykatave në Çështjet e Personelit, Buxhetit dhe Financave, Logjistikës dhe Prokurimit dhe në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit të nënshkruar me datë 12 korrik 2022, sipas së cilit kompenzimi do të realizohet nga AKP, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës publikon:

**KONKURSIN Nr. 01/2022
(Marrëveshje për Shërbime të Veçanta)**

Pozita: Zyrtar Ligjor ----- 10 (dhjetë) pozita;
Institucioni: Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Përshkrimi i detvrave të punës

Titulli i pozitës: Zyrtar Ligjor ----- 10 (dhjetë) pozita;

Titulli i mbikëqyrësit: Administratori i Gjykatës

Paga: “Pagesa për Ofruesit e Shërbimeve është 450 €. Në këtë shumë përfshihen edhe pagesa për kontributet pensionale (5%) nga punëdhënësi dhe (5%) nga punëmarrësi dhe tatimit në burim sipas legjislacionit në fuqi.”

Kohëzgjatja kontratës: 6 (gjashtë) muaj, me mundësi vazhdimi

Orari i punës: 08:00 – 16:00

Qëllimi i vendit të punës: Ofron mbështetje për pranimin, regjistrimin, menaxhimin, me lëndët me të cilat është ngarkuar Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, sipas legjislacionit në fuqi, akteve normative të miratuara nga Këshilli

Detyrat Kryesore:

- Organizon dhe mirëmban shkresat e dosjeve të lëndëve në gjykatë si dhe kujdeset për të ofruar punë cilësore20%
- Pranon dhe regjistron lëndët sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.....20%
- Përgatit të gjitha lëndët të cilat i kanë plotësuar kushtet ligjore për regjistrim dhe i raporton te mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.....20%
- Sipas kërkesës ndihmon shtypjen e vendimeve dhe shkresat tjera të gjykatës, përfshirë përgatitjen e dosjeve të lëndëve gjyqësore20%
- Kryen edhe detyra tjetër sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe përgatitë raportet javore të punës.20%

Shkathësitë/aftësitë e kërkuara:

- Shkathësi të shkëlqyera gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim. E nevojshme
- Njohja e punës me kompjuter (Word dhe Excel). E nevojshme

Kualifikimet arsimore dhe profesionale dhe përvoja e punës për këtë post:

- Diplome Universitare: **Jurist i diplomuar** -----E nevojshme
- Se paku 1 (një) vit përvojë pune -----E nevojshme

Konkursi është publikuar më datë: **14 korrik 2022 dhe mbyllet 22 korrik 2022**

Afati i aplikimit për këto pozita është **8 ditë kalendarike** nga data e publikimit në ueb faqen zyrtare të KGJK-së dhe në tabelën e shpalljeve të Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme.

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në:

Zyra e pranimit/ Sekretariati i KGJK-së, Rr. “Luan Haradinaj” nr.133, Prishtinë

Aplikacionin mund ta shkarkoni online Web faqen e KGJK-së (www.gjyqesori-rks.org).
Shkarko Aplikacionin

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhurë në listën e ngushtë do të kontaktohen.

- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Republikës së Kosovës. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara.**


Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë:

- kopjen e leternjoftimit
- CV e kandidatit
- kopja e diplomës;
- përvoja e punës;
- certifikatën që nuk jeni nën hetime;
- certifikata të tjera, nëse keni;

Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjiti dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u përfshirë në listën e ngushtë të kandidatëve.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT – SECRETARIAT

Na osnovu člana 11. stav 4. Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi Republike Kosova, Administrativnog uputstva SSK-a br. 04/2016 od 04.11.2016. god. o postupku regrutacije za zapošljavanja sa ugovorima pod nazivom „Sporazum o posebnim uslugama“, koji podležu Zakonu o obligacionim odnosima, na osnovu Administrativnog uputstva (br. 01/2019) o podeli odgovornosti SSSK-a i sudova po pitanju osoblja, budžeta i finansija, logistike i nabavke, i u skladu sa memorandumom o razumevanju između Sudskog saveta Kosova i Kosovske agencije za privatizaciju, potpisana dana 12.jula 2022.godine, prema kome će nadoknadu realizovati KAP, Sekretarijat Sudskog saveta Kosova objavljuje:

**KONKURS br. 01/2022
(Sporazum o posebnim uslugama)**

Pozicija: Pravni službenik ----- 10 (deset) pozicije;
Institucija: Posebna komora Vrhovnog suda

Opis radnih zadataka

Naziv radnog mesta: Pravni službenik

Naziv nadzornika: Administrator suda

Plata: „Plaćanje za ponuđača usluga je 450 evra. Ovaj iznos uključuje i uplate za penzijske doprinose (5%) od poslodavca i (5%) od zaposlenog i porez po odbitku u skladu sa zakonima na snazi.“

Trajanje ugovora: 6 (šest) meseci, sa mogućnošću nastavka

Radno vreme: 08:00 – 16:00

Svrha radnog mesta: Pruža podršku za prijem, registrovanje, upravljanje sa predmetima sa kojima je zadužen Posebna komora Vrhovnog suda, po zakonima na snazi, normativnih akata usvojenih od Saveta.

Glavni zadaci:

- Organizuje i održava spise predmeta u sudu kao i stara se o kvalitetnom radu20%
- Prima i registruje predmete po zakonu na snazi i normativnih akata usvojenih od Saveta20%
- Priprema sve predmete koje su ispunile zakonske uslove za registrovanje i izveštava neposrednog nadzornika.....20%
- Na zahtev, pomaže u štampanju odluka i drugih sudskih dokumenata, uključujući i pripremu sudskih spisa predmeta20%
- Obavlja i druge zadatke na zahtev nadzornog i priprema nedeljne izveštaje rada20%

Potrebne veštine/sposobnosti:

- Odlične veštine usmene i pismene komunikacije. Potrebno
- Poznavanje rada na kompjuteru (Word i Excel). Potrebno

Obrazovne i stručne kvalifikacije i radno iskustvo za ovo radno mesto:

- Univerzitetna diploma –**Diplomirani pravnik** -----Potrebno
- Najmanje godinu dana (1) radnog iskustva;----- Potrebno

Konkurs je objavljen dana: **14. jula 2022. i zatvara se 22. jula 2022.**

Rok za podnošenje aplikacije za ovu poziciju je **8 kalendarskih dana** od dana objavljivanja na zvaničnoj veb stranici SSK-a i na oglasnoj tabli Posebne komore Vrhovnog suda.

Aplikaciju možete preuzeti i dostaviti u:

Kancelariji za prijem/Sekretarijat SSK-a, ul. “Luan Haradinaj” br. 133, Priština

Aplikaciju možete preuzeti online na veb stranici SSK-a (www.gjyqesori-rks.org).

Preuzmi aplikaciju

Aplikacije se ne prihvataju nakon isteka konkursnog roka. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktiraće se samo kandidati koji su izabrani u užu krug.

- Pravo na konkurisanje imaju svi stanovnici Republike Kosova. U aplikaciju se moraju upisati svi traženi podaci.**

Uz aplikaciju se prilažu i potrebna dokumenta za konkurisanje, kao što su:

- Kopija lične kartice;
- CV kandidata;
- Kopija diplome;
- Radno iskustvo
- Potvrda da niste pod istragom;
- Druge potvrde, ako ih imate;

Ako uz aplikaciju ne priložite potrebna dokumenta i ako je ne popunite tačnim podacima, sami ćete izgubiti priliku da budete uvršteni u užu spisak kandidata.



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori: Prof. Dr. Bajram Kosumi Ref.nr. 01 /1138 Dt. 13.07.2022

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1.2 dhe nenit 168 paragrafi 4 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" dhe Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, Ref.nr.01/742 të dt. 28.04.2022, bazuar edhe në Vendimin e Këshillit Drejtues, Nr. 02/1111 dt. 08.07.2022, Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, shpall

K O N K U R S

Për emërimin/riemërimin e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan.

Fakulteti i Edukimit

- Një mësimdhënës/e për lëndët: *Metodologji e leximit letrar, Metodatat e shkrim – leximit, Edukatë estetike* (programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); *Lojërat gjuhësore* (programi: Arsimi Parashkollor); *Mësimi i gjuhës shqipe përmes IT* (programi master: Mësimdhënës dhe Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)
- Një mësimdhënës/e për lëndët: *Praktika pedagogjike IV, Praktika pedagogjike III, Huluntimi në edukim* (programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor), Mësimdhënësia efektive (programi master: Mësimdhënës dhe Kurrikula në Arsimin Fillor)
- Një mësimdhënës/e për lëndët: *Histori kombëtare* (Programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); *Metodologji e shkencave shoqërore* (programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor); *Metodologji e hulumtimit shkencor* (programet master: Mësimdhënës dhe Kurrikula në Arsimin Fillor dhe Mësimdhënës dhe Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe)
- Një mësimdhënës/e për lëndët: *Bazat e arsimit muzikor; Interpretimi në një instrument muzikor; Këndimi koral* (Programet: Arsimi Parashkollor dhe Arsimi Fillor)

Fakulteti Juridik

- Një mësimdhënës për lëndët: *Hyrje në të drejtën Civile, E drejta Civile, E drejta e sigurimeve, E drejta detyrimeve dhe E drejta noteriale.*

Fakulteti Ekonomik

- Një mësimdhënës për lëndët: *Marketingu elektronik, Marketingu Ndërkombëtar, Marketingu i Shërbimeve, Sjellje Konsumatore, Projekt, Menaxhimi i shitjes dhe lëndë të tjera nga fusha e marketingut dixhital.*
- Një mësimdhënës për lëndët: *Parimet e kontabilitetit, Bazat e kontabilitetit menaxherial, Kontabiliteti menaxherial, Kontabiliteti i institucioneve dhe lëndë të tjera nga fusha e financave dhe kontabilitetit.*

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

- Një mësimdhënës për lëndët: *Bazat e të dhënave, Siguria e kualitetit të softuerëve, Vizualizim dhe procesim i imazheve, Kriptografia dhe Siguria e rrjetave, Modelimi kompjuterike dhe simulimi, Siguria e rrjetave.*
- Një mësimdhënës për lëndët e nivelit master në programin E Qeverisje: *Menaxhimi dhe ruajtja e informacionit, Informatika sociale, Arkivimi dixhital dhe sistemet informative, Programet Aplikative në E- Qeverisje, e-Qeverisja dhe programimi, Databaza për E- Qeverisje dhe Zhvillimet në Cloud.*
- Një mësimdhënës për lëndët e nivelit master në programin Sistemet e kontrollit dhe intelgjencia artificiale: *Teoria e kontrollës dhe praktika, Kontrolla e adaptueshme, Sistemet e bazuara në sensor, Sistemet Hibride dhe të integruara të kontrollit, Sensorët dhe elektronika dhe Menaxhimi i energjisë.*
- Një asistent/e për lëndët: *Zhvillimi i aplikacioneve, Inxhinieri softuerike, qarqet dixhitale, Arkitektura e kompjuterë dhe SO, Rrjetet kompjuterike dhe dizajnim multimedia, Web teknologji, Rrjetet dhe cloud, TIK (Fakulteti i Edukimit Arsimi Fillor dhe Arsimi Parashkollor).*

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën;
- Biografinë (CV);
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, të noterizuara;
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit;
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës);
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënës dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënës në arsimin e lartë;
- Certifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet bachelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

- Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL, TOEIC apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, (shih:<https://www.uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUTI-I-UNIVERSITETIT-%E2%80%9DKADRI-ZEKA-%E2%80%9D-N%C3%8B-GJILAN.pdf>) dhe Rregullores Nr.01/742 dt.28.04.2022 për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në ueb-faqe.

Paraqitja e dokumenteve fillon më 14.07.2022 dhe përfundon më 28.07.2022.

Dokumentet dorëzohen në zyrën nr. 4.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularin F1 të cilin mund ta shkarkojnë nga ueb-faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike së bashku me dokumentet e tjera e dërgojnë në info@uni-gjilan.net si dhe i tërë dokumentacioni sjellët në kopje fizike në UKZ.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit:



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektor: Prof. Dr. Bajram Kosumi Ref.br.01/1138 Dana. 13.07.2022

Na osnovu odredaba iz čl.8 Zakona o radu br.03/L-212, odredaba iz čl.26 Zakona o visokom obrazovanju Kosova br.04/L-037, čl.47 st.1 podst.1.1.2 i čl.168 st.4 Statuta Javnog Univerziteta "Kadri Zeka" i Pravilnika o izbornim procedurama koji se odnosi na imenovanje, ponovno imenovanje i napredovanje akademskog osoblja, Ref.br.01/742 od 28.04.2022, bazirajući se i na Odluku Upravnog Saveta br.02/1111 od 08.07.2022, Senat Javnog Univerziteta "Kadri Zeka" u Gnjilanu, objavljuje

K O N K U R S

Za imenovanje/ponovno imenovanje redovnog akademskog osoblja u akademskim jedinicama Javnog Univerziteta "Kadri Zeka" u Gnjilanu.

Pedagoški fakultet

- Nastavnik za predmete: *Metodika književnog čitanja, Metodika čitanja i pisanja, Estetsko vaspitanje (programi: Predškolsko vaspitanje i obrazovanje i Osnovno obrazovanje), Jezičke igre (Program predškolsko vaspitanje), Učenje albanskog jezika kroz IT (master program: Nastava albanskog jezika i književnosti)*
- Nastavnik za predmete: *Pedagoška praksa IV, Pedagoška praksa III, Istraživanje u obrazovanju (programi: predškolskog vaspitanja i obrazovanja i Osnovnog obrazovanja), Efektivna nastava (master program: Nastava i nastavni plan i program u Osnovnom obrazovanju).*
- Nastavnik za predmete: *Nacionalna istorija (programi predškolskog vaspitanja i obrazovanja i osnovnog obrazovanja), Metodika društvenih nauka (programi predškolskog vaspitanja i obrazovanja i osnovnog obrazovanja), Metodologija naučno-istraživačkog rada (master programi, Nastava i nastavni plan i program u osnovnom obrazovanju i nastava Albanskog jezika i književnosti).*
- Nastavnik za predmete: *Osnovi muzičkog vaspitanja i obrazovanja, Interpretacija-izvođenje na muzičkom instrumentu, Horsko pevanje (programi: predškolskog i osnovnog obrazovanja).*

Pravni fakultet

- Nastavnik za predmete: *Uvod u građansko pravo, Građansko pravo, Pravo osiguranja, Obligaciono pravo i Notarsko pravo.*

Ekonomski fakultet

- Nastavnik za predmete: *Elektronski marketing, Međunarodni marketing, marketing usluga, Ponašanje sa potrošačima, Projekat, Upravljanje prodajom i druge predmete iz oblasti digitalnog marketinga.*
- Nastavnik za predmete: *Principi računovodstva, Osnovi upravljačkog računovodstva, Menadžersko računovodstvo, Računovodstvo ustanova i drugi predmeti iz oblasti finansija i računovodstva.*

Računarski fakultet

- Nastavnik za predmete: *Baze podataka, Obezbeđenje kvaliteta softvera, Vizuelizacija i obrada slika, Kriptografija i bezbednost mreže, Računarsko modeliranje i simulacija, Bezbednost mreže.*
- Nastavnik za predmete master nivoa u programu E-Uprava: *Upravljanje i čuvanje informacija, Društvena informatika, Digitalno arhiviranje i informacioni sistemi, Aplikacioni programi u E-Upravi, E-Uprava i programiranje, Baza podataka za E-Upravu i razvoj u Cloud.*
- Nastavnik za predmete master nivoa na programu Upravljački sistemi i veštačka inteligencija, *Teorija i praksa upravljanja, Adaptivno upravljanje, Sistemi zasnovani na senzovima, Hibridni i integrisani sistemi upravljanja, Senzori i elektronika i upravljanje energijom.*
- Asistent za predmete: *Razvoj aplikacija, Softversko inženjerstvo, Diditalni krugovi, Arhitektura računara i SO, Dizajn računarskih mreža i multimedije, Veb tehnologije, Mreže i cloud, TIK (Pedagoški fakultet Osnovno i predškolsko obrazovanje).*

Kandidati koji se pojave na konkursu moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zahtev
- Biografiju (CV)
- Kopiju diplome o završenim studijama, magistarskih i doktorskih studija, overena
- Certifikat sa ocenama na tri nivoa studija
- Izvod rođenih
- Potvrdu o državljanstvu (ili potvrdu prebivališta u R. Kosovo)
- Dokaz(kopije) za naučne radove, monografije, udbenike, publikacije u međunarodnim naučnim ili umetničkim časopisima, aktivno učešće na domaćim i međunarodnim konferencijama, itd.
- Dokaz o iskustvu nastavničkog rada i drugih profesija u oblasti nastave u visokom obrazovanju;
- Dokaz da se protiv njega ne vodi istraga.
- Dokaz o poznavanju stranog jezika.

Kandidati koji su doktorirali ili završili bachelor studije ili magistraturu u inostranstvu moraju dostaviti dokaze o nostrifikaciji diplome od strane MONT-a.

Kandidati treba da donesu jedan od ovih dokumenata kao dokaz o poznavanju stranog jezika:

- Da su završili jedan od nivoa studija stranih jezika ili certifikat IELTS, TOEFL, TOEIC ili bilo koji drugi važeći dokument.

Kandidati moraju ispunjavati sve uslove propisani Zakonom o visokom obrazovanju u R. Kosovo br.04/L-037, Statutom Univerziteta "Kadri Zeka" u Gnjilanu, (vidi: <https://www.uni-gjilane.net/wp-content/uploads/2020/12/STATUT-UNIVERZITETA-%E2%80%9DKADRI-ZEKA-%E2%80%9D-N%C3%8B-GNJILANE.pdf>) i Pravilnika br.01/742 od 28.04.2022, o izbornim procedurama koji se odnosi na imenovanje, ponovno imenovanje i napredovanje akademskog osoblja u UKZ.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana, od dana objavljivanja na sajtu.

Dokumentacija se može podneti od 14.07.2022 do 28.07.2022.

Podnošenje dokumenata se vrši u kancelariji br.4.

Kandidati trebaju popuniti Formular F1, koji mogu izvaditi iz sajta univerziteta i elektronskim putem zajedno uz ostalu dokumentaciju pošalj u info@uni-gjilan.net ili fizičkim putem u UKZ.

Aplikacije koje stignu nakon isteka roka kao i nekompletirane aplikacije neće se razmotriti uopšte.

Konkurs možete naći na zvaničnom sajtu univerziteta:

<http://www.uni-gjilan.net>





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

